

VENDIM
Nr. 295, datë 2.5.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ISHËM, TË QARKUT TË DURRËSIT

(ndryshuar me VKM-në nr. 63, datë 8.2.2023)¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Ishëm të qarkut të Durrësit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 83 (tetëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 549 (pesëqind e dyzet e nëntë).

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Ishëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Ishëm
Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
15-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve shëndetësore	Në pronësi
22-32	Varrezat publike	Në pronësi
322-335, 337, 339, 389-428	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
343-344, 349, 354, 359, 364-365, 370, 372, 376, 378, 379, 384, 388, 472, 473, 487, 493, 506, 524, 525, 532, 533, 547, 549	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
340-342, 345-348, 350-353, 373-375, 385-387, 356-358, 361-363, 367-369, 380-382	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

¹ Me VKM-në nr. 63, datë 8.2.2023, sipas pikës 1 të tij:

"1. Pronës me numër rendor 12, sipas listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, bashkëlidhur vendimit nr. 295, datë 2.5.2012, të Këshillit të Ministrave, me numër pasurie 119, zona kadastrale 1204, i ndryshon sipërfaqja, sipas formularit dhe planit të rievimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi."

Shtuar me VKM-në nr. 63, datë 8.2.2023

(Per inventarizimin e pronave të veçanta)

Durrell

Njesia Administrative Ishem

Fusha e përdorimit të Pronës:

Arsim

Identifikoi:

Per Bashkine Durres: Kadi Gjyli (Administrator)

Supervizori:

Faton Zeqiri, Enis Bahiti, Ardita Molla, Jetmir Xupi, Anila Murbja (Specialiste)
Per ASH-kre: *Imma Bushi*
Leonard Dervishi (Specialist)
Pergj i Zyres se Pronave *Imma Bushi*

Pergj. i Zyres se Pronave

Elio Jami

Emiriana Sako

(emri, mblemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Kryetar i Bashkise

Nr. Rend.	Zona Kadasir. & Indeksit i Hartes	A			B			C			Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
		Nr. Pasurise	Lloji i Promes	Emri i Promes Adresa	Sip. Totale e Promes (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Mderese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Proma	Institucioni / Enti me pergjigjesi administrative	Institucion / Enti perdoret Statusi juridik i perdornit		
1	1204	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
12	K-34-88-(82-B) K-34-88-(82-A)	119	Truall Mderese	Bize Nj Administrative Isahem Bashkia Durres	2463	240	Asrim parashkollor	Bashkia Durres	Bashkia Durres	Sip-2463m2 edhe pise e pasurise 119 S1 objekt 2 kat = 181m2 S2 objekt 1kat= 89m2	